



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 27

2002

Qershor

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i Kuvendit nr. 41, datë 6.6.2002	Për një ndryshimin në vendimin e Kuvendit nr.461, datë 16.11.2000 “Për miratimin e strukturës, të organikës dhe vendeve të punës të sekretariatit teknik , tabelës së pagave dhe buxhetit të Komisionit të Shërbimit Civil për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2000”.....	857
Vendim i Kuvendit nr. 42, datë 6.6.2002	Për përfundimet e shqyrtimit të vendimeve nr.75, datë 19.4.2002 dhe nr.76, datë 25.4.2002 të Gjykatës Kushtetuese.....	858
Vendim i Kuvendit nr. 43, datë 6.6.2002	Për disa ndryshime në komisionet e përhershme të Kuvendit.....	859
Vendim i Kuvendit nr. 44, datë 6.6.2002	Për një ndryshim të Vendimin e Kuvendit nr.37, datë 16.5.2002 “Për krijimin e Komisionit të Integritetit Europian dhe Paktit të Stabilitetit” i ndryshuar.....	859

Dekret nr. 3366, datë 12.6.2002	Për lejim lënie të shtetësisë shqiptare.....	860
Vendim i KM nr. 253, datë 6.6.2002	Për një shtesë në vendimin nr. 439, datë 4.8.2000 të Këshillit të Ministrave “Për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë”.....	861
Vendim i KM nr. 254, datë 13.6.2002	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.62, datë 7.3.2002 të Këshillit të Ministrave “Për dhënien në përdorim të përkohshëm, pa shpërblim, të vilës 30”.	862
Vendim i KM nr. 255 datë 13.6.2002	Për rritjen e pensioneve suplementare.....	865
Vendim i KM nr. 256, datë 13.6.2002	Për rritjen e pensioneve.....	866
Vendim i KM nr. 257, datë 13.6.2002	Për mënyrën dhe procedurën e pagimit të kontributeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.....	867
Vendim i KM nr. 258, datë 13.6.2002	Për përcaktimin e bazës së vlerësimit vjetor, individual, për llogaritjen fillestare të pensionit.....	868
Vendim i KM nr. 259, datë 13.6.2002	Për disa ndryshime në vendimin nr.3, datë 5.1.2002 të Këshillit të Ministrave “Për strukturën e Komitetit Kombëtar të Digave të Mëdha (KKDM)”.....	869
Vendim i GjK nr. 134, 17.6.2002	Me objekt shfuqizimin si antikushtetues të vendimeve nr.1228, datë 14.12.2000 të Gjykatës së Apelit të Tiranës dhe nr.799, datë 13.7.2001 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (Dhoma e Këshillimit)”.....	869
Vendim i GjK nr. 135, datë 17.6.2002	Me objekt shfuqizimin si antikushtetues të neneve 30 e 36 të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, si dhe neneve 21 dhe 36 të ligjit nr.8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.	872

V E N D I M
Nr. 41, datë 6.6.2002

**PËR NJË NDRYSHIMIN NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 461, DATË 16.11.2000 “PËR
MIRATIMIN E STRUKTURËS, TË ORGANIKËS DHE VENDEVE TË PUNËS TË
SEKRETARIATIT TEKNIK , TABELËS SË PAGAVE DHE BUXHETIT TË KOMISIONIT
TË SHËRBIMIT CIVIL PËR GJASHTËMUJORIN E DYTË TË VITIT 2000”**

Në mbështetje të nenit 5 pikat 9 dhe 11 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, si dhe të nenit 88 të Rregullores së Kuvendit,

K U V E N D I

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:**

I. Tabela e pagave nr.2 të Sekretariatit Teknik të Komisionit të Shërbimit Civil, miratuar me vendimin e Kuvendit nr.461, datë 16.11.2000 “Për miratimin e strukturës, të organikës dhe vendeve të punës të sekretariatit teknik, tabelës së pagave dhe buxhetit të Komisionit të Shërbimit Civil për gjashtëmuja të dytë të vitit 2000”, ndryshohet sipas lidhjes nr.1 bashkëlidhur këtij vendimi.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Servet Pëllumbi

Lidhja nr.1

Tabela e pagave të sekretariatit teknik të Komisionit të shërbimit civil, mbështetur në vendimin e Kuvendit nr.35, datë 14.5.2002 dhe në klasifikimin e pagave sipas strukturës e nivelit të pagave, përcaktuar në vendimin e këshillit të ministrave nr.711, datë 27.12.2001.

Nr.	Emërtimi	Klasifikimi i pagës
1	Shefi i Kabinetit dhe Zëdhënësi i Komisionit	II-a
2	Sekretare e Kryetarit	IV-a
3	Sekretari i Përgjithshëm	I-b
4	Drejtori i Personel –Organizimit dhe Shërbimeve Drejtori i Mbikëqyrjes dhe Ankesave	II-b
5	Inspektor, këshilltar	III-b
6	Shef Sektori i Administratës; Shef Sektori i Financës; Shef Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë	III-a
7	Specialist, ekonomist, specialist personeli	III-b
8	Specialist arkiv-protokoll	IV-a

V E N D I M
Nr. 42, datë 6. 6. 2002

**PËR PËRFUNDIMET E SHQYRTIMIT TË VENDIMEVE NR.75, DATË 19.4.2002 DHE
NR.76, DATË 25.4.2002 TË GJYKATËS KUSHTETUESE**

Në mbështetje të neneve 28 dhe 88 të Rregullores së Kuvendit, pas shqyrtimit në Komisionin e Përhershëm të Çështjeve Kushtetuese dhe Ligjore dhe Komisionin e Përhershëm të Imunitetit, Mandateve dhe Rregullores të vendimeve nr.75, datë 19.4.2002 dhe nr.76, datë 25.4.2002 të Gjykatës Kushtetuese,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË V E N D O S I:

I. Të ngarkojë Komisionin e Përhershëm të Imunitetit, Mandateve dhe Rregullores dhe Komisionin e Përhershëm të Çështjeve Kushtetuese dhe Ligjore për të përgatitur ndryshimet përkatëse në Rregulloren e Kuvendit, në lidhje me përmirësimet e procedurave të emërimit dhe të shkarkimit të funksionarëve të lartë të parashikuar në Kushtetutë, për t'u ndjekur e zbatuar në të ardhmen nga Kuvendi.

II. Në bazë të nenit 178 pika 2 të Kushtetutës, t'i kërkojë Këshillit të Ministrave të përgatisë dhe të sjellë sa më parë në Kuvend ndryshimet e nevojshme në ligjin nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë".

III. Në bazë të nenit 28 të Rregullores së Kuvendit, njoftohet Këshilli i Ministrave për këtë vendim të Kuvendit.

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Servet Pëllumbi

V E N D I M Nr. 43, datë 6.6.2002

PËR DISA NDRYSHIME NË KOMISIONET E PËRHERSHME TË KUVENDIT

Në mbështetje të neneve 28 dhe 88 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Kryetarit të Kuvendit,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË V E N D O S I:

I. Në komisionet e përhershme të Kuvendit bëhen këto ndryshime:

1. Deputeti Vangjel Dule bëhet anëtar i Komisionit të Përhershëm për të Drejtat e Njeriut dhe Minoritetet.

2. Deputeti Kristo Goçi bëhet anëtar i Komisionit të Përhershëm për Çështjet Kushtetuese dhe Ligjore dhe i Komisionit të Përhershëm për Arsimin, Shkencën e Sportet, duke zëvendësuar në këtë të fundit deputetin Vangjel Dule.

3. Deputetët Fatbardha Shabanaj dhe Rahmi Mehmetllari bëhen anëtarë të Komisionit të Përhershëm për Arsimin, Shkencën e Sportet, duke plotësuar vendet vakante.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Servet Pëllumbi

V E N D I M Nr. 44, datë 6.6.2002

PËR NJË NDRYSHIM TË VENDIMIN E KUVENDIT NR.37, DATË 16.5.2002 "PËR

KRIJIMIN E KOMISIONIT TË INTEGRIMIT EUROPIAN DHE PAKTIT TË STABILITETIT” I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 22, 30 dhe 88 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Kryetarit të Kuvendit,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË V E N D O S I:

I. Numri i anëtarëve të Komisionit të Integrimit Europian dhe Paktit të Stabilitetit nga 14 anëtarë të bëhet në 16 anëtarë.

II. Përbërja e Komisionit ndryshohet si më poshtë:

1. Deputetët Ben Blushi dhe Fatos Beja bëhen anëtarë të Komisionit.

2. Deputeti Ilir Zela zëvendësohen në Komisionin deputetin Taulant Dedja.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI
Servet Pëllumbi**

D E K R E T Nr. 3366, datë 12.6.2002

PËR LEJIM LËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” të Kushtetutës, të neneve 15, 19 dhe 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Rendit Publik,

D E K R E T O J:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Ilir Ramazan Dashi
2. Nuri Hamza Mehmetaj
3. Xhemile Ahmet Mehmetaj (Zenelaj)
4. Afërdita Hamza Beka (Xhaja)
5. Nina Luan Beka
6. Tobias Luan Beka
7. Petrika Dhimosten Adam
8. Agim Haxhi Berishaku
9. Fatmir Novruz Veliaj
10. Arjan Jorgji Llazo
11. Fatmir Hamdi Mici
12. Luan Ramis Lazaj
13. Amanda Luan Lazaj
14. Urani Kovaç Lazaj (Bregasi)
15. Jani Mihal Drita
16. Luljeta Shaqir Peza (Koçi)
17. Anisa Gëzim Peza
18. Xhina Gëzim Peza

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Rexhep Meidani

V E N D I M
Nr. 253, datë 6.6.2002

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 439, DATË 4.8.2000 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR HYRJEN, QËNDRIMIN DHE TRAJTIMIN E TË HUAJVE NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të paragrafit të dytë të pikës 2 të nenit 9 dhe të paragrafit të tretë të nenit 83 të ligjit nr. 8492, datë 27.5.1999 “Për të huajt”, me propozimin e Ministrit të Rendit Publik dhe Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr. 439, datë 4.8.2000 të Këshillit të Ministrave, pas pikës 4 shtohet pika 4.1, me këtë përmbajtje:

“4.1. Shtetasit e huaj, që i përkasin shteteve të përcaktuara në lidhjen nr. 8/1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi, hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë pa vizë, gjatë periudhës së sezonit turistik veror, 15 qershor deri 15 shtator”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

Lidhja 8/1

Praktika e lëshimit të vizës në Republikën e Shqipërisë

1. Shtetasit e huaj me kombësi shqiptare mund të hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë gjatë periudhës së sezonit turistik veror, 15 qershor deri 15 shtator, pa vizë, duke i paraqitur policisë kufitare çdo dokument të vlefshëm udhëtimi.

2. Hyjnë pa vizë në territorin e Republikës së Shqipërisë, gjatë periudhës së sezonit turistik veror, 15 qershor deri 15 shtator, shtetasit e shteteve të mëposhtme:

1. Çekia
2. Hungaria
3. Kroacia
4. Polonia
5. Serbia – Mali i Zi
6. Sllovakia
7. Sllovenia

V E N D I M
Nr. 254, datë 13.6.2002

**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.62, DATË 7.3.2002 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TË PËRKOHSHËM, PA
SHPËRBLIM, TË VILËS 30”.**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7 të Kodit të Procedurave Administrative dhe të neneve 14 dhe 15 shkronja “c” të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të

shtetit”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.62, datë 7.3.2002 të Këshillit të Ministrave “Për dhënien në përdorim të përkohshëm, pa shpërblim, të vilës 30”, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pika 1 të ndryshohet si më poshtë vijon:

“1. Institutit të Trajnimit të Administratës Publike dhe Komisionit të Shërbimit Civil t’u jepet në përdorim të përkohshëm, pa shpërblim, vila 30, me të gjithë territorin përreth. Instituti dhe Komisioni nuk kanë të drejtë t’ua japin mjediset e kësaj vile në përdorim, pa shpërblim apo me qira, të tretëve.”.

2. Pika 2 të ndryshohet si më poshtë vijon:

“2. Ngarkohen Instituti i Trajnimit të Administratës Publike dhe Komisioni i Shërbimit Civil të përballojnë shpenzimet për mirëmbajtjen e pronës së dhënë në përdorim.”.


3. Pas pikës 3 të shtohet pika 4, me këtë përmbajtje:


“4. Ngarkohet Instituti i Trajnimit të Administratës Publike të vërë në dispozicion të Komisionit të Shërbimit Civil pjesën e mjediseve, sipas skemës që i bashkëlidhet këtij vendimi.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Pandeli Majko







V E N D I M
Nr. 255, datë 13.6.2002

PËR RRIJTJEN E PENSIONEVE SUPLEMENTARE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 13 të ligjit nr.8087, datë 13.3.1996 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Shërbimit Informativ Shtetëror”, ndryshuar me ligjin nr.8521, datë 30.7.1999 dhe të nenit 1 të ligjit nr.8455, datë 4.2.1999 “Për një trajtim të veçantë të familjeve të pilotëve që humbasin jetën në përmbushje të detyrës gjatë fluturimit”, me ndryshimet përkatëse, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Pensionet e parakohshme për vjetërsi shërbimi dhe pensionet suplementare të ushtarakëve, të caktuara sipas ligjit nr.8087, datë 13.3.1996 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Shërbimit Informativ Shtetëror”, ndryshuar me ligjin nr.8521, datë 30.7.1999, me datë fillimi deri më 30.6.2002, përfshirë dhe këtë datë, rriten në masën 10 për qind.

2. Pensionet familjare, të caktuara sipas ligjit nr.8455, datë 4.2.1999 “Për një trajtim të veçantë

të familjeve të pilotëve që humbasin jetën në përmbushje të detyrës, gjatë fluturimit”, me ndryshimet përkatëse, me datë fillimi deri më 30.6.2002 përfshirë dhe këtë datë, rriten në masën 10 për qind.

3. Efektet financiare për rritjen e përfitimeve të përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij vendimi të përballohen nga buxheti i vitit 2002, miratuar për Institutin e Sigurimeve Shoqërore dhe llogariten si më poshtë vijon:

- 48 014 000 (dyzet e tetë milionë e katërbëdhjetë mijë) lekë për pensionet e parakohshme për vjetërsi shërbimi dhe pensionet suplementare të ushtarakëve;

- 627 000 (gjashtëqind e njëzeteshtatë mijë) lekë për pensionet familjare, të familjeve në ngarkim të pilotëve që kanë humbur jetën në përmbushje të detyrës, gjatë fluturimit.

4. Ngarkohet Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga 1.7.2002.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M **Nr. 256, datë 13.6.2002**

PËR RITJEN E PENSIONEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshimet përkatëse, dhe të nenit 3 të ligjit nr.7663, datë 20.1.1993 “Për statusin e invalidit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Pensionet e pleqërisë, pensionet e parakohshme të pleqërisë, pensionet familjare, pensionet për merita të veçanta dhe pensionet për vjetëri shërbimi, të caktuara sipas ligjeve nr.4171, datë 13.9.1966 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” dhe nr.7703, datë 11.5.1993, me ndryshimet përkatëse, rriten në masën 10 për qind.

2. Pensionet e pleqërisë, pensionet e invaliditetit dhe pensionet familjare, të caktuara sipas ligjit nr.4976, datë 29.6.1972 “Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën e Shqipërisë”, si dhe pensionet e caktuara sipas paragrafit të katërt të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, me ndryshimet përkatëse, rriten në masën 25 për qind.

3. Pensionet e invaliditetit, të caktuara sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, me ndryshimet përkatëse, rriten në masën 20 për qind.

4. Rritjen e pensionit e përfitojnë:

a) Në masën 10 për qind, edhe pensionet e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, të cilat caktohen pas datës 1.7.2002, me kusht që data e fillimit të pensionit të jetë përpara datës 30.6.2002, përfshirë edhe këtë datë;

b) në masën 25 për qind, edhe pensionet e përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi, të cilat caktohen pas datës 1.7.2002, me kusht që data e fillimit të pensionit të jetë përpara datës 30.6.2002, përfshirë edhe këtë datë;

c) në masën 20 për qind, edhe pensionet e përcaktuara në pikën 3 të këtij vendimi, të cilat caktohen pas datës 1.7.2002, me kusht që data e fillimit të pensionit të jetë përpara datës 30.6.2002, përfshirë edhe këtë datë;

5. Pensioni i plotë i pleqërisë, pensioni i plotë i invaliditetit dhe pensioni i plotë familjar, të caktuara sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, me ndryshimet përkatëse, me datë fillimi nga 1.7.2002 e në vazhdim, nuk caktohen më pak se 6 116 lekë në muaj dhe jo më shumë se 12 232 lekë në muaj.

Pensionin i plotë i pleqërisë, pensionin i plotë i invaliditetit dhe pensionin i plotë familjar, të caktuara sipas paragrafit të katërt të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, me ndryshimet

përkatëse, me datë fillimi 1.7.2002 e në vazhdim, nuk caktohen më pak se 2 158 lekë në muaj.

6. Shtesa mujore e përfituar nga vendimi nr.326, datë 21.6.1993 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret e trajtimit të invalidëve të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar” rritet në masën 10 për qind.

7. Pensionet e posaçme dhe shtesat e pensioneve të posaçme shtetërore, të caktuara sipas nenit 5 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, me ndryshimet përkatëse, rriten në masën 10 për qind.

8. Pensionet e caktuara sipas dekretit nr.758, datë 1.2.1994 “Për një mbrojtje të veçantë të ushtarakut”, rriten në masën 10 për qind.

9. Efektet financiare, që rrjedhin nga rritja e pensioneve për vitin 2002, llogariten në shumën 1 600 milionë lekë dhe përballohen:

a) nga fondet e parashikuara në buxhetin e vitit 2002, miratuar për Institutin e Sigurimeve Shoqërore, në 1 524 milion lekë;

b) nga rezultati financiar i vitit 2001, në 76 milionë lekë.

10. Ngarkohet Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.7.2002.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M
Nr. 257, datë 13.6.2002

PËR MËNYRËN DHE PROCEDURËN E PAGIMIT TË KONTRIBUTEVE PËR SIGURIMET
SHOQËRORE DHE SHËNDETËSORE

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 15 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me ligjet përkatëse, dhe të nenit 11 të ligjit nr.7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me ligjet përkatëse, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Personat, juridikë e fizikë, të paraqesin në bankën ku kanë llogarinë rrjedhëse urdhrin për pagimin e kontributeve mujore për sigurimet shoqërore e shëndetësore jo më vonë se data 30 e muajit pasardhës.

2. Institucionet buxhetore të paraqesin në bankën ku kryejnë veprimet e tyre, nëpërmjet llogarisë së Drejtorisë së Thesarit, së bashku me çekun për tërheqjen e pagave të pesëmbëdhjetëditëshit të dytë, urdhrin për pagimin e kontributeve mujore për sigurimet shoqërore e shëndetësore; ndryshe institucioni buxhetor nuk mund të tërheqë pagat e punonjësve.

3. Të vetëpunësuarit, individë a pjesëtarë në ortakëri, ose dhe personat që sigurohen vullnetarisht, pagimin e kontributeve për sigurimet shoqërore e shëndetësore mund ta bëjnë edhe me para në dorë, pranë bankave ose në rrjetin e postës shqiptare, brenda afateve dhe kriterëve në fuqi.

4. Instituti i Sigurimeve Shoqërore të lidhë marrëveshje me bankat e nivelit të dytë dhe me postën shqiptare për zbatimin e këtij vendimi.

5. Vendimi nr.261, datë 7.6.1993 i Këshillit të Ministrave “Për derdhjen e detyrimeve ndaj sigurimeve shoqërore” shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M
Nr. 258, datë 13.6.2002

**PËR PËRCAKTIMIN E BAZËS SË VLERËSIMIT VJETOR, INDIVIDUAL, PËR
LLOGARITJEN FILLESTARE TË PENSIONIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 32 e 59 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshimet përkatëse, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Koeficientët për indeksimin e bazës mesatare vjetore, të vlerësueshme, individuale, që personat e siguruar kanë realizuar nëpërmjet pagimit të kontributeve, për efekt të llogaritjes fillestare të pensionit, të jenë si më poshtë vijon:

Për vitin 20011
Për vitin 20001.07
Për vitin 19991.17
Për vitin 19981.22
Për vitin 19971.49
Për vitin 19961.63
Për vitin 19952.23
Për vitin 19942.94

2. Efektet financiare që lindin në çastin e llogaritjes fillestare të pensioneve si rrjedhojë e zbatimit të koeficientëve të përcaktuara në pikën 1, të përballohen nga buxheti i vitit 2002, miratuar për Institutin e Sigurimeve Shoqërore.

3. Vendimi nr.360, datë 27.5.2001 i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e bazës së vlerësimit vjetor, individual, për llogaritjen fillestare të pensionit” shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.1.2002.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M
Nr. 259, datë 13.6.2002

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.3, DATË 5.1.2002 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR STRUKTURËN E KOMITETIT KOMBËTAR TË DIGAVE TË
MËDHA (KKDM)”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4 e 13 të ligjit nr.8681, datë 2.11.2000 “Për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e digave dhe dambave”, me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.3, datë 5.1.2002 të Këshillit të Ministrave të bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshon si më poshtë vijon:

“1. Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) të ketë në përbërje 11 veta.

- Kryetari dhe nënkryetari emërohen nga Kryeministri me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe Turizmit.

- Sekretar është sekretari i Sekretariatit Kombëtar të Digave të Mëdha, pranë Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe Turizmit.

- Anëtarët emërohen nga Ministri i Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, sipas propozimeve, si më poshtë vijon:

a) 4 anëtarë nga Ministri i Industrisë dhe Energjetikës;

b) 3 anëtarë nga Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit;

c) 1 anëtar nga Akademia e Shkencës”.

2. Pika 2 ndryshohet si më poshtë vijon:

“2. Si organ këshillimor, pranë KKDM-së, funksionon Këshilli Teknik i Përhershëm i Digave (KTPD), i cili përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, që emërohen nga Ministri i Rregullimit të Territorit dhe Turizmit.”.

3. Në pikën 3 shifra “30%” të zëvendësohet me “20%”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M
Nr. 134, 17.6.2002

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergj Sauli	Anëtar i Gjykatës Kushtetuese
Alfred Karamuço	Anëtar i “““
Kristofor Peçi	Anëtar i “““
Kujtim Puto	Anëtar i “““
Petrit Plloçi	Anëtar i “““
Zija Vuci	Anëtar i “““

me sekretare Arbenka Lalica, në datat 15.2.2002 dhe 15.5.2002, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.28 Akti që i përket:

K ë R K U E S:MAHMUDIE, XHEVRIJE E SABIRE KAZAZI, përfaqësuar nga avokate Hanëme Bakia dhe Shpëtim Kazazi, me prokurë.

SUBJEKT I INTERESUAR:ALEKSANDER, ILIR e MUKADES GAVOÇI, trashëgimtarë ligjorë të Olimbi Gavoçit, përfaqësuar nga avokatët Viktor Ikonimi e Maksim Ostreni, me prokurë.

O B J E K T I:Shfuqizimi si antikushtetues i vendimeve nr.1228, datë 14.12.2000 të Gjykatës së Apelit të Tiranës dhe nr.799, datë 13.7.2001 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (Dhoma e Këshillimit)”.

BAZA LIGJORE:Neni 131 shkronja “F” të Kushtetutës.

Në kërkesën drejtuar Gjykatës Kushtetuese, kërkesit kanë parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin e këtyre vendimeve:

Gjykata e Lartë nuk ka respektuar kërkesat për një proces të rregullt ligjor. Ajo nuk ka mbajtur qëndrim ndaj shkëljes që ka kryer gjykata e apelit, e cila, në kundërshtim me nenin 6 të Kodit të Procedurës Civile, nuk është shprehur për të gjitha kërkimet që përfshihen në objektin e padisë.

Edhe sikur të pranohet që Ismail Baruti të ketë bërë disponime me testament në favor të së paditurës, kjo do të thotë që ai i ka lënë asaj vetëm pasurinë që ka pasur në kohën e vdekjes, por jo edhe për pasuritë e tjera që u janë kthyer më vonë, me vendim të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, trashëgimtarëve të babait të tij Ali Riza Baruti.

Në gjykimin e kësaj çështjeje janë lejuar edhe shkelje të tjera procedurale, si dhe nuk është respektuar ligji “Për noterinë”. Konkretisht, nuk është vërtetuar ekzistenca e testamentit ollograf të

pretenduar nga e paditura. Ky akt nuk i bashkëngjitet procesverbalit që ka mbajtur noterja e Shkodrës, e cila ka pasqyruar aty vetëm deklarimet gojore të të paditurës, dhe jo përmbajtjen e testamentit të pretenduar prej saj.

Në këto rrethana, marrja për bazë e këtyre provave shkresore, të redaktuara në kundërshtim me ligjin, nuk pajtohet me kërkesat e Kushtetutës që kanë të bëjnë me procesin e rregullt ligjor.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Zija Vuci, përfaqësuesit e kërkuësve, të subjektit të interesuar dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor të Tiranës është ngritur në vitin 1999 një padi në emër të Lutfije Barutit, motër e kërkuësve Mahmudie, Xhevrije dhe Mukades Kazazi. Objekt i kësaj padie, fillimisht, ka qenë njohja e paditëses si trashëgimtare e vetme ligjore e bashkëshortit të saj, Ismail Ali Baruti, vdekur në Tiranë në vitin 1986, si dhe detyrimi i të paditurës Olimbi Gavoçi, nënë e subjekteve të interesuara, Aleksandër, Ilir e Mukades Gavoçi, t'i dorëzojë asaj pasurinë trashëgimore që i vjen prej tij.

E paditura, në formë prapësimi, ka pretenduar se këtë pasuri e ka fituar në bazë të një testamenti ollograf, të përpiluar nga i lartpërmenduri si vëlla i saj, i cili, me këtë akt të vullnetit të fundit, i ka mbyllur rrugën çeljes së trashëgimisë në favor të paditëses.

Për të vërtetuar këtë fakt, e paditura ka paraqitur midis provave shkresore edhe dëshminë testamentare të redaktuar në vitin 1994 në zyrën noteriale të Shkodrës.

Në përgjigje të këtij prapësimi, përfaqësuesi i paditëses (e cila nuk ka marrë pjesë në gjyq), ka shtuar objektin e padisë dhe ka kërkuar anulimin si të pavlefshëm të testamentit në fjalë, duke parashtruar se ky ka cenuar rezervën ligjore që i takonte asaj si trashëgimtare e radhës së parë dhe si person i paaftë në ngarkim të trashëgimlënësit, Ismail Baruti.

Ka rezultuar se, gjatë gjykimit në shkallë të parë, ka ndodhur vdekja e paditëses. Në këtë fazë është bërë zëvendësimi i saj procedural, me kërkuësit si trashëgimtarë të vetëm ligjorë. Në përfundim të shqyrtimit të çështjes, Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Tiranës, me vendimin nr.2389, datë 13.7.2000, ka vendosur pranimin pjesërisht të padisë për konstatimin e pavlefshmërisë së testamentit ollograf datë 10.4.1983 dhe detyrimin e të paditurës Olimbi Gavoçi të njohë si trashëgimtare ligjore të paditëses Lutfije Baruti, mbi gjysmën e pasurisë trashëgimore që ka lënë Ali Riza Baruti, babai i Olimbisë dhe i testatorit Ismail Baruti, si dhe pushimin e gjykimit për pjesët e tjera të padisë.

Mbi ankimin e të paditurës Olimbi Gavoçi, Gjykata e Apelit të Tiranës, me vendimin nr.1228, datë 14.12.2000, ka ndryshuar vendimin e sipërm të gjykatës së rrethit dhe duke e gjykuar çështjen në fakt ka vendosur rrëzimin e padisë si të pabazuar në prova dhe në ligj.

Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit të Tiranës, kanë ushtruar rekurs të tria kërkuëset, por Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.779, datë 13.7.2001, ka vendosur në Dhomën e Këshillimit, mospranimin e këtij rekursi si të pabazuar në ligj.

Duke mos u pajtuar me këtë zgjidhje, kërkuëset i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin e këtyre vendimeve. U konstatua se pas ushtrimit të kësaj kërke kishte ndodhur edhe vdekja e Olimbi Gavoçit dhe në vend të saj u thirrën dhe morrën pjesë në seancë plenare subjektet e interesuara: Aleksandër, Ilir e Mukades Gavoçi si trashëgimtarë ligjorë të radhës së parë.

Gjykata Kushtetuese, duke krahasuar përmbajtjen e kërkesës objekt gjykimi me provat e administruara në seancë plenare, çmon se pretendimet e kërkuësve për papajtueshmëri me Kushtetutën të vendimeve gjyqësore të sipërpërmendura janë të pabazuara. Pretendimi i tyre se gjykatat nuk kanë vënë në diskutim dhe nuk janë shprehur për të gjitha kërkimet që përbëjnë objektin e padisë, nuk i përgjigjet realitetit.

Gjykata e apelit ka prishur vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe, duke e gjykuar çështjen në fakt, ka vendosur rrëzimin e padisë. Ajo ka pranuar se kërkuëset nuk legjitimohen të kërkojnë anulimin e testamentit objekt gjykimi dhe të përfitojnë nga rezerva ligjore e trashëgimlënësës së tyre Lutfije Baruti. Sipas gjykatës, e drejta për kërkimin e kësaj rezerve është një e drejtë personale, që i takonte vetëm kësaj të fundit, por, me vdekjen e saj, kjo është shuar dhe nuk iu kalon

trashëgimtarëve.

Pra, me këtë vendim, gjykata i ka dhënë zgjidhje të njëjtë edhe dy kërtimeve të tjera të pretenduara nga kërkuueset, gjë që del e qartë nga vetë pjesa urdhëruese e këtij vendimi. Në këtë pjesë ajo është shprehur për rrëzimin në tërësi të padisë, ç'ka do të thotë se ka rrëzuar të gjitha kërkimet që përbëjnë objektin e saj.

Ky konkluzion argumentohet me faktin se, përderisa ka lënë të paprekur testamentin, ajo ka ligjëruar trashëgiminë testamentare dhe i ka mbyllur rrugën zbatimit të dispozitave të Kodit Civil “Mbi trashëgiminë ligjore” për t'i njohur kërkuueset si trashëgimtare mbi pasurinë, e cila përfaqëson rezervën ligjore të trashëgimlënësës së tyre.

Veç sa sipër, një pretendim i tillë nuk është ngritur nga kërkuueset as në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë. Në këtë rekurs nuk janë parashtruar, gjithashtu, as shkaqet ligjore për të cilat ato kanë kërkuar shfuqizimin e vendimit të gjykatës së apelit. Përmbajtjen e këtij rekursi, nga fillimi deri në fund e përshkon përpjekja e tyre, që, nëpërmjet analizës dhe çmimit të provave në mënyrë të ndryshme nga të dyja gjykatat, të ngrenë pretendime, të cilat gjykata i ka verifikuar dhe nuk i ka pranuar.

Kështu, në kundërshtim me faktet e pranuar nga gjykata e shkallës së parë, me vendimin e së cilës kërkuueset kanë qenë dakord dhe nuk e kanë kundërshtuar pranë gjykatës së apelit, në rekurs ato kanë dalë me pretendimin se ish-kunati i tyre, Ismail Baruti, nuk ka lënë fare testament, por për të vërtetuar se ky akt ka ekzistuar, noterja që ka lëshuar dëshminë testamentare në emër të Olimbisë ka falisifikuar dokumentat.

Në këto rrethana, Gjykata Kushtetuese çmon se vlerësimi që i ka bërë Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë këtyre pretendimeve, duke mos i konsideruar këto si shkaqe ligjore që meritojnë të shqyrtohen në seancë gjyqësore, nuk përmban në vetvete elementë të një procesi jo të rregullt ligjor.

Në këtë rast, ai, duke vendosur në Dhomën e Këshillimit mospranimin e rekursit, nuk ka dalë jashtë kompetencave të veta dhe nuk ka marrë atributet që ka si gjykatë, kur gjykon çështjen në seancë gjyqësore.

Të njëjtën natyrë, por të shtjelluar në një mënyrë tjetër, kanë edhe problemet e ngritura në kërkesën drejtuar Gjykatës Kushtetuese. Edhe këto, ashtu si ato të parashtruara në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë, bazohen në analizën e çmimit të provave dhe nuk i përmbahen konkluzioneve ose kritereve që ka zbatuar gjykata e rrethit dhe e apelit për vlerësimin e tyre.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 131/f të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

V E N D I M Nr. 135, datë 17.6.2002

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci	Anëtar i “““
Alfred Karamuço	Anëtar i “““

Kristofor Peçi	Anëtar i	“““
Kujtim Puto	Anëtar i	“““
Petrit Plloçi	Anëtar i	“““
Tefta Zaka	Anëtare e	“““
Sokol Sadushi	Anëtar i	“““
Gjergj Sauli	Anëtar i	“““

me sekretare Arbenka Lalica, në datat 24.1.2002, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.214/14 Akti që i përket:

K Ë R K U E S:SHOQATA E INDUSTRIALISTËVE DHE INVESTITORËVE TË SHQIPËRISË, përfaqësuar nga avokat Fatmir Braka dhe zotërinjtë Altin Ylli, Sekretar i Përgjithshëm i Shoqatës dhe Kujtim Shkreli, anëtar i kësaj shoqate, me autorizim.

SUBJEKT I INTERESUAR:KËSHILLI I MINISTRAVE, përfaqësuar nga zotërinjtë Kujtim Brovina, Drejtor i Përgjithshëm i Tatimeve dhe Genc Çifligu, Drejtor i Legjislacionit në Ministrinë e Financave, me autorizim.

O B J E K T I:Shfuqizimi si antikushtetues i neneve 30 e 36 të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, si dhe neneve 21 dhe 36 të ligjit nr.8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

BAZA LIGJORE:Nenet 11, 16/2, 42/2 e 134 të Kushtetutës, si dhe neni 12 i Kodit të Procedurave Administrative.

Në kërkesën për shfuqizimin si antikushtetues të dispozitave përkatëse të ligjeve të mësipërme me Kushtetutën janë parashtruar në mënyrë të përmbledhur këto shkaqe:

Neni 30 i ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat” vjen në kundërshtim me nenet 11 dhe 16/2 të Kushtetutës, sepse detyron tatimpaguesit që të parapagujnë tatimin para fillimit të veprimtarisë dhe lejon organet tatimore që të ndryshojnë masën e tatimit gjatë vitit në vazhdim.

Neni 36 i ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat” vjen në kundërshtim me nenet 11 dhe 16/2 të Kushtetutës, sepse kjo dispozitë i lë dorë të lirë subjektivizmit të organeve tatimore në përcaktimin e personave të lidhur.

Neni 21 i ligjit “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” vjen në kundërshtim me nenin 42/2 të Kushtetutës, sepse Komisioni i Apelit të Tatimeve, që shqyrton ankesat e tatimpaguesve, nuk është krijuar si një organ i pavarur dhe i paanshëm.

Neni 36 i ligjit “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” vjen në kundërshtim me nenin 11 të Kushtetutës, sepse metoda alternative e aplikuar sipas këtij neni për përcaktimin e detyrimit tatimor dëmton lirinë e veprimtarisë ekonomike.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Gjergj Sauli, përfaqësuesit e kërkuarit, të subjektit të interesuar dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Shoqata e Industrialistëve dhe Investitorëve të Shqipërisë me kërkesën e saj të paraqitur në datën 10.12.2001 ka kërkuar shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të neneve 30 e 36 të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” dhe të nenit 36 të ligjit nr.8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

Kjo shoqatë, po në datën 10.12.2001, paraqiti në Gjykatën Kushtetuese një kërkesë tjetër për shqyrtim, me të cilën kërkoi shpalljen si të papajtueshëm me Kushtetutën të nenit 21 të ligjit nr.8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

Gjykata Kushtetuese, nisur nga fakti se këto dy kërkesa janë paraqitur nga i njëjti kërkuar dhe se kanë të përbashkët në objektin e tyre shfuqizimin e dispozitave që i përkasin ligjit “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me vendimin e ndërmjetëm datë 24.01.2002, bashkoi këto kërkesa në një gjykim të vetëm.

Pas paraqitjes së kërkesave për shqyrtim, Gjykata Kushtetuese konstatoi se ligji “Për tatimin mbi të ardhurat” dhe të ligjit “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, kanë pësuar ndryshime, respektivisht, me ligjin nr.8841, datë 11.12.2001 dhe me ligjin nr.8846, datë 11.12.2001.

Këto ndryshime, krahas dispozitave të tjera, kanë prekur edhe nenin 30 të ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat”, si dhe nenet 21 e 36 të ligjit “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, dispozita këto që përbëjnë objektin e gjykimit të çështjes në shqyrtim.

Pala kërkuese ndryshimet e bëra në dispozitat e mësipërme nuk i konsideroi të rëndësishme, prandaj kërkoi që ato edhe të ndryshuara të deklarohen si të papajtueshme me Kushtetutën. Në këto kushte, lidhur me pretendimet e parashtuara në dy kërkesat e mësipërme të bashkuara proceduralisht në një gjykim të vetëm, Gjykata Kushtetuese konkludon si më poshtë:

Legjislacioni tatimor në Republikën e Shqipërisë, duke qenë instrument i politikës ekonomike e sociale të shtetit, është ndërtuar në përputhje me kërkesat e nenit 155 të Kushtetutës, sipas të cilit “Taksat, tatimet dhe detyrimet financiare kombëtare e vendore, lehtësimi ose përjashtimi prej tyre i kategorive të caktuara të paguesve, si dhe mënyra e mbledhjes së tyre caktohen me ligj”.

Dispozitat objekt gjykimi, që i përkasin ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat” dhe ligjit “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, si pjesë e legjislacionit tatimor, janë hartuar në përputhje me frymën dhe kërkesat që përshkojnë nenin e mësipërm të Kushtetutës. Kështu, në ligjin “Për tatimin mbi të ardhurat” në nenin 30 të tij janë vendosur rregulla për tatimpaguesit në lidhje me parapagimin e detyrimeve tatimore, si dhe për rritjen e tyre për periudhën vijuese tatimore. Qëllimi i vendosjes së këtyre rregullave është garantimi i mbledhjes së tatimeve dhe shmangja e fenomenit negativ të mospagimit të tyre.

Duke iu referuar përmbajtjes së nenit 30 të ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat”, del qartë se kjo dispozitë përcakton mënyrën e mbledhjes së tatimeve. Fakti nëse detyrimi tatimor mbi fitimin do të parapaguhet ose jo ka të bëjë me mënyrën e aplikuar në ligj të mbledhjes së tatimeve, dhe jo me antikushtetutshmërinë e kësaj dispozite.

Nisur nga sa sipër, Gjykata Kushtetuese konkludon se pala kërkuese nuk vërtetoi pretendimin e saj për papajtueshmërinë me Kushtetutën të nenit 30 të ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat”. Mënyra e parashikuar në këtë dispozitë për mbledhjen e tatimit nuk sjell asnjë lloj kufizimi për lirinë e veprimtarisë ekonomike të tatimpaguesve, në kuptim të nenit 11 të Kushtetutës. Nëse kjo dispozitë, siç pretendohet nga pala kërkuese, ka vërtet mangësi, ato mund të përbëjnë shkak për ndryshimin ose plotësimin e saj, por jo për ta shfuqizuar atë si të papajtueshme me Kushtetutën.

Me nenin 36 të ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat”, vendosen rregullat e nevojshme për pasqyrimin e veprimtarisë reale ekonomike të tatimpaguesve, në rastet kur kjo veprimtari zhvillohet midis personave të lidhur, të cilët transferojnë fitimet nëpërmjet çmimeve. Ky kuptim del qartë nga qëllimi i kësaj dispozite, që është parandalimi i manipulimit të çmimeve, pavarësisht nga mospërputhja që ekziston ndërmjet titullit dhe përmbajtjes së saj.

Pala kërkuese, nenin e mësipërm e quan të papajtueshëm me Kushtetutën, me pretendimin se në ligjin “Për tatimin mbi të ardhurat” nuk jepet qartë kuptimi i personave të lidhur, gjë, që sipas saj, u ka krijuar organeve tatimore një situatë të favorshme për të vepruar me subjektivizëm në përcaktimin e këtyre personave. Ky pretendim është i papranueshëm, sepse një dispozitë ligjore nuk mund të quhet e papajtueshme me Kushtetutën, për faktin se në praktikën e zbatimit të saj lejohet subjektivizmi.

Përmirësimi i legjislacionit tatimor është një proces i pandërprerë, që synon të realizojë politikën shtetërore në fushën e tatimeve, duke mbrojtur si interesat e shtetit, ashtu dhe të tatimpaguesve dhe duke luftuar vazhdimisht evazionin fiskal. Nisur nga një qëllim e synim i tillë, me ligjin nr.8841, datë 11.12.2001, janë bërë përmirësimet e nevojshme në ligjin “Për tatimin mbi të ardhurat”. Në këtë ligj, veç neneve të tjera, përmirësimet janë bërë edhe në nenin 2, në të cilin ndryshe nga pretendimi i palës kërkuese për “personat e lidhur”, është dhënë një përcaktim më i plotë, duke u bërë njëkohësisht edhe ndarja e personave të lidhur në tre kategori të caktuara.

Përsa sipër, Gjykata Kushtetuese konstaton se neni 36 i ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat”, duke patur si qëllim parandalimin e manipulimit të çmimeve prej personave të lidhur, nuk prek ndonjë nga parimet kushtetuese të ekonomisë së tregut dhe nuk vendos kufizime në lirinë e veprimtarisë ekonomike të tatimpaguesve.

Komisioni i Apelit të Tatimeve, në nenin 21 të ligjit “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet si një organ administrativ me kompetenca të plota për shqyrtimin e kundërvajtjeve administrative në fushën e tatimeve. Ky nen është ndryshuar me ligjin nr.8846, datë 11.12.2001 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”. Komisioni i Apelit të Tatimeve, sipas formulimit të ri, ka rritur numrin e anëtarëve dhe të fushave nga ata propozohen ose zgjidhen. Komisioni përbëhet

nga 7 anëtarë prej të cilëve: 3 emërohen nga Ministri i Financave, 3 të tjerë emërohen me propozim të shoqatave të biznesit, të shoqatave të ekonomistëve etj. dhe 1 nga Ministri i Drejtësisë.

Me këtë riformulim, neni 21 i ligjit “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, ndryshe nga sa pretendon pala kërkuese, nuk vjen në kundërshtim me nenin 42/2 të Kushtetutës.

Me dispozitën e mësipërme janë krijuar më tej kushtet dhe hapësirat e nevojshme që Komisioni i Apelimit si organ i administratës publike të zbatojë parimin e paanësisë në ushtrimin e kompetencave të veta në trajtimin e të gjitha subjekteve me të cilat hyn në marrëdhënie. Ky parim i rëndësishëm, që përshkon administratën publike në ushtrimin e funksioneve të veta, është parashikuar shprehimisht në nenin 12 të Kodit të Procedurave Administrative.

Komisioni i Apelimit të Tatimeve, duke qenë një organ administrativ i paanshëm, është krijuar në përputhje me nenin 13 të ligjit nr.7697, datë 7.4.1993 “Për kundërvajtjet administrative”, në të cilin thuhet se organi administrativ që shqyrton kundërvajtjet administrative dhe përbërja e tij caktohen me dispozita të veçanta. Konkretisht, ky komision është parashikuar si një organ i tillë në nenin 21 të ligjit “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”. Në këtë ligj, veç sa sipër, jepen edhe garanci të tjera për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese dhe ligjore të tatimpaguesve, sepse në të është parashikuar që veprimtaria e këtij komisioni t’i nënshtrohet edhe kontrollit gjyqësor. Ky fakt gjen shprehje në nenin 59 të këtij ligji, me të cilin tatimpaguesve u është njohur e drejta që t’i drejtohen gjykatës me ankim kundër vendimeve të komisionit, pasi të kenë ndjekur të gjitha shkallët e ankimit administrativ.

Metodat alternative të përcaktimit të detyrimit tatimor jepen në nenin 36 të ligjit “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”. Ky nen, me ndryshimet që pësoi, nuk ka prekur parimet kushtetuese të përcaktuara në nenin 11 të Kushtetutës. Për të luftuar evazionin fiskal, organet tatimore sipas këtij neni, mund të rikarakterizojnë transaksionet për të reflektuar situatën ekonomike reale të tatimpaguesve, por në aplikimin e kësaj metode, rikarakterizimi i transaksioneve është lejuar që të bëhet prej organeve tatimore vetëm në tre raste taksative. Këto raste janë:

së pari, kur tatimpaguesi, për një periudhë të caktuar tatimore nuk ka deklaruar detyrimet e tij tatimore, siç parashikohet në ligje të veçanta tatimore;

së dyti, kur gjatë kontrollit të kryer nga organet tatimore nuk gjendet dokumentacioni i duhur për përcaktimin e detyrimit tatimor ose kur ky dokumentacion ka mangësi serioze, të cilat nuk lejojnë paraqitjen e situatës reale të tatimpaguesve;

së treti, kur tatimpaguesit manipulojnë çmimet e shitjes.

Përsa më sipër, del e qartë se rikarakterizimi i transaksioneve nuk është rregull, por përjashtim dhe për rastet që ai lejohet, në kundërshtim me pretendimet e palës kërkuese, nuk prek lirinë kontraktore të tatimpaguesve, por është një mjet efektiv për të luftuar evazionin fiskal.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 131/f të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”,

V E N D O S I:

- Njëzëri, për rrëzimin e kërkesës për shfuqizimin si antikushtetues të neneve 30 e 36 të ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat”, si dhe për nenin 21 të ligjit “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

- Me shumicë votash, për rrëzimin e kërkesës për shfuqizimin si antikushtetues të nenit 36 të ligjit “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Fletorja Zyrtare gjendet:

- Në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Rr.Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

U dorëzua për shtyp më 20. 6. 2002
Doli nga shtypi më 21. 6. 2002

Tirazhi: 4250 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2002

Çmimi: 150 lekë

